



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura VI**  
Sesioni pranveror

**Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi**

Mbledhja nr. 58  
Prishtinë, më 15.3.2019, në orën 10:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Ismajl Kurteshi, kryetar, Teuta Haxhiu, Mufera Shinik, Driton Çausi, Abdyl Salihu, Luljeta Veselaj-Gutaj dhe Verica Çeraniç.

**Munguan:** Arbërie Nagavci, Valentina Bunjaku-Rexhepi, Fidan Rekaliu dhe Albulena Balaj-Halimaj.

**Përfaqësues të tjerë:** Shyqiri Bytyqi, ministër i MASHT-it, Rahman Jasharaj, kryetar i SBASHK-ut, Gjeni Shporta, Jeta Zagragja e Blendrit Elezaj, përfaqësues të KAEF-it dhe përfaqësues të mediave.

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Për këtë mbledhje u propozua ky

**Rend i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Diskutim lidhur me kompensimin e orëve të humbura nga greva e mësimdhënësve;**
- 3. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

## **1. Miratimi i rendit të ditës;**

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

## **2. Diskutim lidhur me kompensimin e orëve të humbura nga greva e mësimdhënësve;**

Ismajl Kurteshi, në hapje të mbledhjes përshëndeti ministrin e MASHT-it dhe kryetarin e SBASHK-ut për pjesëmarrjen e tyre. Ai tha se qëllimi i këtij takimi të përbashkët ka të bëjë me diskutimin e çështjes së kompensimit të mësimit të humbur gjatë tri javëve si pasojë e grevës së mbajtur nga punëtoret e arsimit, grevë kjo e mësimdhënësve, e cila më së shumti i ka dëmtuar nxënësit. Kurteshi tha se humbja është e pakompensueshme, megjithatë nuk është njëjtë sikur të kompensohen apo jo orët e humbura.

Komisioni vlerëson se kompensimi i orëve duhet të ndodhë, pavarësisht shpjegimeve që dikush mund ti gjejë të bazuara në ligj ose kudo qoftë, sepse nëse mësimi nuk kompensohet do të humbin fëmijët, pra qëndrimi i Komisionit është publik, duke kërkuar mirëkuptim dhe duke kërkuar që fëmijët të mos pësojnë.

Shyqyri Bytyqi, në diskutimin e tij tha se, orët e humbura janë si pasojë e grevës e cila ka qenë e organizuar nga SBASHK-u për tre javë, për çka si ministri që nga dita e parë, kanë deklaruar se kërkesat e sindikatës janë të drejta por nuk e kemi përkrahur dhe jemi kundër qëndrimit të sindikatës që kundërshton kompensimin e orëve. Ai tha se ka bërë gjithçka është e mundur si ministër për realizimin e kërkesave të sindikatës dhe ndërprerjes së grevës, por nuk ka qenë në kompetencën e MASHT-it të vendos për koeficient edhe përkundër që vazhdimisht kemi bërë kërkesa për ngritjen e tyre. Në bashkëpunim me DKA-të kanë nxjerr këtë vendim, të cilin e kemi paraqitur edhe në takim me Komisionin parlamentar dhe vlerëson se është forma më mirë që kompensimi do të ndodhë, pesë ditë të vikendeve, pesë ditë në pushimin pranveror dhe pesë ditë në fundin e vitit shkollor. Vendimi i marrë për kompensimin e orëve është ligjor, bazuar në Ligjin për Arsimin parauniversitar dhe obligimeve tona si MASHT, që të krijojnë kushte të barabarta që të gjithë nxënësit, të kenë një standard të mirë të edukimit, dhe po ashtu, udhëzimi administrativ që obligon që të kemi një vit kalendarik, i cili duhet të jetë në përputhje me datat dhe me normat të cilat janë të përcaktuara në udhëzimin administrativ.

Nuk duhet lejuar që një nxënës i klasës së parë t'i humb pesëmbëdhjetë ditë mësim, e që mund të jenë edhe shtatë shkronja minimumi, apo edhe shumë lëndë të tjera, që janë të rëndësishme qoftë për klasat e dyta, të treta, apo maturantë. Vlerësimi i tij ishte se vendimi është mirëpritur nga shumë mësimdhënës, nxënës e prindër. Vendimi i ministrisë ka filluar të zbatohet, dhe për individët që do e pengojnë këtë vendim, do marrim masa tjera procedurale të bazuara në ligjin në fuqi që askush nuk duhet ta pengojë procesin mësimor.

Rrahman Jasharaj, tha se Komisionit është keqinformuar lidhur me veprimet e SBASHK-ut. SBASHK-u duke u bazuar në Ligjin për grevat, e konsideron me të drejtë vendimin e ministrit të MASHT, si një vendim që nuk bazohet në ligj, andaj është ngritur padë kundër një vendimi të

tillë dhe janë në pritje të vendimit të gjykatës kompetente. Gjykata ka refuzuar kërkesën e SBASHK-ut për masë të përkohshme ndaj vendimit të MASHT-it, por nuk e kanë refuzuar padinë në tersi, andaj kjo çështje do të trajtohet në seancë dhe presin vendim meritot.

Jasharaj tha se Ligji i grevave nuk e obligon askënd që të kompensojë ditët e humbura gjatë grevës, veprimet e deputeteve po bëjnë që në të ardhmen të zbehët fuqia e grevës, pse në të ardhmen të bëj grevë dikush, nëse dihet paraprakisht që ata do të detyrohen t'i zëvendësojnë ditët e humbura. Po ashtu, Jasharaj tha se nuk është e vërtetë që oferta e parë e kryeministrit është e njëjta me ata që është lidhë marrëveshja. Oferta e parë është hedhur poshtë sepse nuk ka qenë as për së afërmi kërkesave të tyre. Ofertë tjetër që iu është ofruar ka qenë nga kryetari i Komisionit për Administratë publike z. Hasani, propozimi ka qenë 0.15% por jo 15% siç është paraqitur në opinionin. Po ashtu, tha se iu kanë dërguar letër të gjithëve që është menduar që mund të bëjnë diçka që të dalim nga ajo krizë, dhe ka dalë ministri Hamza, i cili ka thënë që nga rezervat e fundit do të intervenojë, dhe ka dalë oferta tjetër. Nuk është e vërtetë që SBASHK-u ka ndikuar që punëtorët nga klasa e parë e deri në të pestën të jenë më pak të shpërblyer me koeficient si arsimtarët lëndor, por nuk kemi mundur të bëjmë më shumë sepse është MASHT-i ai që ka rangu sistemet arsimore, fakulteti, shkolla e mesme e lartë, shkolla e mesme e ulët, arsimit fillor, çerdhet. Askush nuk mund t'i detyrojë mësuesit që t'i zëvendësojnë orët. Mbetet në fuqi vendimi i Këshillit drejtues, kompensim të orëve nuk do të ketë, do ta presim vendimin e gjykatës, çfarëdoqoftë ai, vendimin ne do ta zbatojmë.

Driton Çausi, falënderoi ministrin e MASHT dhe kryetarin SBASHK-ut për kohën e ndarë që të marrin pjesë në këtë takim. Kur SBASHK deklaroi se nuk ka zëvendësim atëherë nuk mbetet asnjë hapësirë për të zbatuar obligimin moral që ju mund ta ndjeni duke përfaqësuar punëtorët e arsimit. Qëndrimi i SBASHK-ut, kundër kompensimit të orëve është presion që i bëhet punëtorëve të arsimit, përveç planit të ministrit, nuk ka asnjë gatishmëri për të kompensuar humbjen që ka ndodhur gjatë grevës, andaj duhet të pranohet që ka obligim moral të paktën. Ideja e këtij takimi sot ka qenë, që të gjendet një zgjidhje, duhet një hap prej jush që të shohim reagimin e punëtorëve të arsimit. Çausi tha se nuk sheh asnjë argument kur SBASHK-u drejton gishtin nga deputetët për diskriminim që është bërë ndaj mësuesve klasorë, sepse SBASHK-u është ai që ka negociua për këtë marrëveshje dhe jo Komisioni për arsim, prandaj SBASHK-u nuk është dashur ta lejojë të ndodhë ky diskriminim. Nga ajo që ka dëgjuar nga ministri, plani për kompensimin e orëve është plan racional sepse të gjithë kanë përgjegjësi, dhe nuk mund t'i ikim, dhe iu kisha lutur shumë që sot, meqë e keni rastin, të jepni kontributin tuaj që të arrijmë një marrëveshje, rreth kësaj çështje.

Teuta Haxhiu, tha që është shumë krenare për punën që e bënë si deputete dhe anëtare e Komisionit për Arsim. Në takimin e fundit të komisionit kanë marrë pjesë përfaqësues të Këshillit të mësimit të mësimit klasor, të cilët janë deklaruar për kompensimin e orëve të humbura. z.Jashari ka qenë pjesë e punës në Komisionin për Administratë, aty ku është

shqyrtuar Projektligji i pagave, ndërsa ne si komision i arsimit nuk kemi marr pjesë në ato takime dhe SBASHK-ut nuk e ka kundërshtuar çështjen e diskriminimit të mësimitdhënësve klasorë. Kjo mund të vërtetohet edhe nga procesverbalet e takimeve të Komisionit për administratë. Si deputetë, nuk kemi qenë në dijeni të këtij diskriminimi, duke menduar që SBASHK nuk bënë një marrëveshje që i diskriminon mësimitdhënësit. Pasi u votua ligji jemi informuar për këtë diskriminim. Qëllimi i këtij takimi është që të paktën t'iu përgjigjemi interesave të nxënësve, pra bëjmë thirrje që, edhe ministria edhe sindikata ta gjejnë një zgjidhje dhe të dalin me një qëndrim. Po ashtu, ajo tha se një test që është mbajtur në Pejë, dhe ku ishin pyetur nxënësit maturanët për përzgjedhjen e profesionit, vetëm 3% e tyre, janë deklaruar që do bëheshin mësimitdhënës. Haxhiu bëri thirrje që MASHT-i në bashkëpunim me DKA-të, të bëjnë një plan për kompensimin e orëve të humbura dhe po ashtu kërkoi nga SBASHK-u që mos të bëhet pengesë në këtë proces.

Luljeta Veselaj-Gutaj, kërkoi nga ministri i MASHT dhe kryetari i SBASHK-ut, një zgjidhje sa me të shpejtë për shkak se në terren është një paqartësi e madhe rreth çështjes së kompensimit të orëve. Ajo tha se nga informatat që ka, në disa shkolla, në disa komuna, do të kompensohen orët edhe këtë vikend, si bie fjala në Suharekë,. andaj ajo vlerësoi se kompensimi i orëve është obligim moral dhe jo vetëm ligjor dhe bëri thirrje për gjetjen e një marrëveshjeje të përbashkët.

Rahman Jasharaj, tha se mos të krijohet një opinion që nuk ekziston. Të gjitha dokumentet flasin, që ne nuk e bëjmë dallimin në ciklin arsimor dhe ndihemi keq me këtë ndarje. Kërkoj që ministri i MASHT-it ta tërheq vendimin për kompensimin e orëve, sepse kompensimi orëve nuk është obligim ligjor. Në momentin që tërhiqet ai vendim do të thirret Këshilli drejtues dhe do të diskutohet lidhur me kompensimin e orëve të humbura.

Shyqyri Bytyqi, tha se u përmend disa herë që ministria e ka sjellë Ligjin e pagave, kjo s'është e vërtetë. Diskriminimi ka ndodhur kur Ministria e Arsimit është larguar dhe nuk ishte pjesë e marrëveshjes me SBASHK-un. Mësimitdhënësit kanë humbur nga kjo, sepse nga viti i ardhshëm dhe nga tri vitet e ardhshme, koeficienti ka qenë nga 3 deri në 3.6, i propozuar nga Ministria e Arsimit e i refuzuar nga SBASHK-u. Vendimi është ligjor, sepse e kemi Ligjin për arsimin parauniversitar, e kemi një udhëzim administrativ që na obligon të kemi një vit kalendarik, dhe mbi bazën e kësaj është marrë vendimi për kompensim të orëve. SBASHK-u nuk mund të marrë vendime, sepse nuk është organ vendimmarrës, ata mund të deklarojnë vetëm moralisht, vendimet merren nga ministria dhe nga DKA-të. DKA-të së bashku me shkollat bëjnë planin për kompensimin e orëve, shembull, Komuna e Prizrenit do të fillojë nga data 23 mars t'i kompensojë orët e humbura, njëjtë do ta ketë Suhareka, pastaj Malisheva.

Ai bëri të qartë edhe njëherë që, se të gjithë ata që pengojnë kompensimin e orëve, ndaj tyre do të marrin masa ligjore.

Ismajl Kurteshi, propozoi që kompensimi i orëve të shtyhet për një javë dhe të fillojë nga data 23 mars dhe deri atëherë, SBASHK-u të ketë kohë për të diskutuar dhe marrë vendim lidhur me kompensimin e orëve.

### **3. Të ndryshme.**

#### **A. Takim me përfaqësues të Fondit Kosovaro -Amerikan për Edukim (KAEF)**

Ismajl Kurteshi, tha se ka qenë kërkesë e përfaqësuesve të Fondit Kosovaro-Amerikan për Edukim (KAEF) për të mbajtur një takim me Komisionin dhe për të paraqitur punën dhe aktivitetet e tyre.

Gjeni Shporta, drejtor i Fondit Kosovaro-Amerikan për Edukim (KAEF), tha se ky takim është në kuadër të takimeve që kanë filluar nga shtatori i vitit të kaluar, me aktorë të ndryshëm vendimmarrës për të përcjellë mesazhin se edukimi është e ardhmja e këtij vendi dhe qëllimi është që ky lloj propozimi të mos ketë ngjyrë politike.

Shporta tha se Fondi Kosovaro-Amerikan për Edukim (KAEF), është një fond i vazhdueshëm edukimi, i cili i dedikohet zhvillimit ekonomik të Kosovës përmes arsimit të popullit të saj. KAEF-i mbështetë programe arsimore të cilat u sigurojnë liderëve të ardhshëm të Kosovës mjetet e nevojshme për të promovuar prosperitetin e ardhshëm të vendit.

Programi i bursave për studime postdiplomike i KAEF-it ofron bursa për studime në universitete amerikane për kosovarët e talentuar, të cilët demonstrojnë përkushtim të fuqishëm ndaj zhvillimit të vendit të tyre. Bursat e KAEF-it janë të hapura për të gjithë aplikuesit e kualifikuar dhe jepen në bazë të meritave përmes një procesi garues. Bursistët studiojnë në programe të nivelit master për një ose dy vjet, marrin diplomën, dhe kryejnë praktikant profesional.

Deri tani, programi ka dhënë 80 bursa, ndërsa të gjithë bursistët janë kthyer në Kosovë për të kontribuar me njohuritë e tyre të fituara në zhvillimin e vendit.

KAEF-i është themeluar nga USAID-i pas përfundimit të Fondit për Financimin e Biznesit në Kosovë, projekt ky përmes së cilit u themelua Banka Amerikane e Kosovës. Mjetet e fituara me shitjen e kësaj banke u shfrytëzuan për themelimin e fondacionit me të cilin menaxhojnë Këshillat Amerikan për Edukim Ndërkombëtar. Ky fondacion tani mbështetet me kontributin e kombinuar të më shumë se 150 ndërmarrjeve, organizatave dhe individëve, si në vend ashtu edhe jashtë tij.

Jeta Zagraxha, tha se fondi i KAEF-it ekziston tash pesëmbëdhjetë vite dhe që prej atëherë kemi 100 (njëqind) bursistë, që kanë përfunduar studimet në Amerikë dhe shumica janë kthyer në Kosovë. Një përqindje prej 45% kontribuojnë në sektorin privat, 28% në sektorin publik dhe një pjesë tjetër janë në organizata joqeveritare dhe institucione ndërkombëtare.

Blendrit Elezaj, tha se ajo çfarë e dallon këtë bursë prej bursave tjera është që kjo e ka modelin

sovrän. Fondi sovrän për arsim është një fond në një shkallë me të madhe, në një shkallë ku qeveria mund ta përdorë këtë fond për të ndryshuar realitetin arsimor në Kosovë.

Ismajl Kurteshi, i falënderoi për prezantimin dhe iniciativën që e paraqitën përfaqësuesit e KAEF-it. Komisioni mund të organizojë një takim mes Fondit Kosovaro-Amerikan për edukim dhe të interesuarve të tjerë për të debatuar rreth këtij propozimi.

Driton Çausi, tha që duke e parë gjendjen në sistemin e arsimit, ideja e prezantuar nga KAEF-i e meriton një trajtim serioz dhe pse të mos bëhet një investim i tillë. Çausi tha se mungon një strategji kombëtare për arsim dhe shpreson që diçka e tillë të nisë në të ardhmen e afërt e të mos vonohet shumë.

Mbledhja përfundoi në orën 11:45.

*E përgatiti:*  
*Stafi mbështetës i Komisionit.*

**Kryetari i Komisionit,**

-----

**Ismajl Kurteshi**